V E N D I M
Nr. 659, datë, 18.12.2002

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", ndryshuar me ligjin nr. 8401, datë 9.9.1998, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve të Teknologjisë Kimike, në varësi të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, shndërrohet në Institutin e Mjedisit, në varësi të Ministrit të Mjedisit.

2. Zyrat dhe mjediset e Institutit të Studimeve dhe të Projektimeve të Teknologjisë Kimike, baza materiale, laboratorët, arkivat dhe struktura organizative i kalojnë në administrim Ministrisë së Mjedisit, për krijimin e Institutit të Mjedisit.

3. Instituti i Mjedisit, në bazë të objektivave të përcaktuar nga Ministri i Mjedisit, zhvillon veprimtarinë e vet, në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera shkencore dhe OJF-të mjedisore, në këto drejtime kryesore:

- Në përpunimin e programeve e të planeve të veprimit për mbrojtjen e mjedisit.
- Në zbatimin e programit të monitorimit të gjendjes së mjedisit.
- Në hartimin e metodikave e të metodologjive bashkëkohore, për monitorimin dhe auditimin mjedisor.
- Në zbatimin e projekteve mjedisore.
- Në verifikimin e saktësisë së të dhënave, për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë me ndikim në mjedis. Laboratori i këtij instituti do të shërbejë si laborator reference.

4. Instituti i Mjedisit financohet nga Ministria e Mjedisit, nga Buxheti i Shtetit, miratuar për këtë ministri, për studime e projektime të miratuara.

5. Instituti i Mjedisit kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe angazhohet në projekte të fushës së tij, me kërkesën e personave juridikë dhe fizikë, publikë a privatë, vendas a të huaj, me anë të kontraktimeve ligjore, të miratuara nga Ministri i Mjedisit, kundrejt një pagese, tarifa e së cilës përcaktohet me akte të veçanta. Të ardhurat e krijuara administrohen nga Instituti i Mjedisit, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin nr. 424, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano